



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 196/8 Prot.

Tiranë, më 14.05.2018

### V E N D I M

**Nr. 44, datë 14.05.2018**

### **MBI PËRFUNDIMIN E VERIFIKIMIT TË INFORMACIONIT TË MARRË NËPËRMJET KËRKESËS SË NËPUNËSES \*\*\*\*\* , PROTOKOLLUAR ME NR. 196 PROT., DATË 24.01.2018**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenet 14 e 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procedurës së verifikimit,

### **VËREJ SE :**

Me anën e kërkesës/informacionit të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me nr. 196 prot., datë 24.01.2018, nëpunësja \*\*\*\*\* , me detyrë “Specialiste në Sektorin e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit”, pranë Bashkisë Shijak, ka ngritur pretendimin se, nga ana e njësisë përgjegjëse nuk janë zbatuar kërkesat ligjore dhe procedurat e parashikuara nga neni 62, “Vlerësimi në punë”, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimi nr. 109, datë 26.02.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”, i ndryshuar, e për rrjedhojë është kryer një vlerësim jo i saktë dhe me përfundime subjektive.

Konkretisht, nëpunësja pretendon se nuk është respektuar zhvillimi i fazës së planifikimit për gjashtëmujorin e dytë, në të cilën duhet të identifikoheshin objektivat kryesore të punës dhe sjelljet profesionale që duhet të përmbusheshin, si dhe nuk është kryer faza e bisedimeve të ndërmjetme, për të vlerësuar progresin. Gjithashtu, vlerësimi vjetor është kryer vetëm me pikë (nuk janë të shoqëruara me komentet përkatëse në lidhje me vlerësimin përfundimtar, arsyet e

*këtij vlerësimi, si dhe me rekomandimet apo vërejtjet e nevojshme, që duhen ndjekur e plotësuar, me qëllim arritjen e rezultateve dhe të objektivave më të larta), duke cenuar në këtë mënyrë kryerjen e një procesi administrativ objektiv dhe të efektshëm për vlerësimin e performancës dhe arritjeve të nëpunësit civil.*

Gjatë zhvillimit të procesit të hetimit administrativ të këtij rasti, njësia përgjegjëse e Bashkisë Shijak, nëpërmjet shkresës me nr. 285 prot., datë 25.01.2018, (*protokolluar në KMSHC me nr. 196/1 prot., datë 29.01.2018*), ka vënë në dijeni Komisionerin se pretendimi i ngritur nga nëpunësja \*\*\*\*\*, nuk duhet të merret në konsideratë sepse procesi ende nuk ka përfunduar. Njëkohësisht, kjo njësi ka informuar se brenda datës 10 shkurt 2018, do të përfundonte procesi dhe pas kësaj, do të vihej në dispozicion të KMSHC, një kopje e formularit të vlerësimit të rezultateve individuale në punë, të nëpunëses \*\*\*\*\*.

Në vijim, me shkresën nr. 285/1 prot., datë 16.02.2018, "*Dërgohet formulari i vlerësimit të rezultateve të punës së nëpunëses \*\*\*\*\**", drejtuar Komisionerit, është dërguar formulari i vlerësimit të punës dhe formulari i përshkrimit të pozicionit të punës së nëpunëses në fjalë, shoqëruar kjo edhe me shkresat e mëparshme nr. 521 prot., datë 13.02.2018, "*Njoftim për dërgimin e pretendimeve në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë*", si dhe përgjigjen e nëpunëses me nr. 521/1 prot., datë 15.02.2018, lidhur me procesin e vlerësimit të rezultateve në punë.

Nga përmbajtja e materialeve të mësipërme, pasi është arritur në përfundimin se kishte dyshime të arsyeshme për parregullsi në zbatimin e ligjit, me Urdhrin nr. 196/3, datë 06.03.2018, "*Për verifikimin e informacionit të ardhur nga nëpunësja \*\*\*\*\**, në lidhje me mosrespektimin e kërkesave gjatë aplikimit të institutit të vlerësimit në punë të nëpunësit civil, nga ana e njësisë përgjegjëse, pranë Bashkisë Shijak", Komisioneri ka urdhëruar nisjen e hetimit administrativ të këtij rasti, lidhur me moszbatimin e kërkesave dhe procedurave të parashikuara nga neni 62, "*Vlerësimi në punë*", i ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar. Në zbatim të këtij urdhri, me shkresat nr. 196/4 prot., dhe nr. 196/5 prot., datë 06.03.2018, janë njoftuar respektivisht Bashkia Shijak dhe ankuesja \*\*\*\*\*.

Në vijim të korespondencës me institucionin, nëpërmjet shkresës nr. 285/3 prot., datë 15.03.2018, me subjekt "*Dërgohet dokumentacioni i kërkuar për verifikimin e ankesës së punonjësës \*\*\*\*\**", drejtuar Komisionerit, janë dërguar aktet:

- ✓ nr. 521/2 prot., datë 20.02.2018, "*Mosshqyrtim i vlerësimit të rezultateve në punë nga zyrtari autorizues*";
- ✓ pretendimet e nëpunëses, protokolluar me aktin nr. 521/3 prot., datë 26.02.2018, lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë;
- ✓ shkresa nr. 521/4 prot., datë 05.03.2018, "*Rivlerësim i rezultateve në punë*" nga zyrtari autorizues.

Nga analiza e materialeve shkresore të dërguara nga institucioni si dhe në bazë të kërkesës/informacionit të paraqitur nga nëpunësja, ka rezultuar që:

Nëpunësja \*\*\*\*\*\*, është emëruar si *“Specialiste në Sektorin e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit”*, pranë Bashkisë Shijak, në datën 23.06.2016. Vlerësimi i parë i rezultateve në punë për këtë punonjëse, që përkon me periudhën e provës ka qenë **3** *“Mjaftueshëm”*, vlerësim të cilin nëpunësja e ka refuzuar, por nuk e ka bërë objekt ankimi në organet kompetente. Pasi i është nënshtruar trajnimit të detyrueshëm pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), ku është vlerësuar pozitivisht, në përfundim të periudhës së provës, nëpunësja në fjalë është konfirmuar nëpunëse civile, në datën 05.07.2017.

Nga përmbajtja e shkresës së Kryetarit të Bashkisë Shijak, me nr. 285/1 prot., datë 16.02.2018, *“Dërgohet formulari i vlerësimit të rezultateve të punës së nëpunëses \*\*\*\*\*”* dhe materialet shkresore bashkëlidhur, rezulton se në përfundim të procesit të vlerësimit periodik të punës së kësaj nëpunëseje, për periudhën korrik-dhjetor 2017, rezulton se është vlerësuar në nivelin **4**, *“Jo kënaqshëm”*. Pasi është njohur me formularin ajo, ka deklaruar se nuk është dakord me vlerësimin dhe ka kërkuar rivlerësim nga zyrtari autorizues, por pa paraqitur pretendime dhe argumente konkrete, për kryerjen e këtij rivlerësimi (*shkresa me nr. 521/1 prot., datë 15.02.2018*).

Pas kësaj me shkresën nr. 521 prot., datë 13.02.2018, *“Njoftim për dërgimin e pretendimeve në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë”*, Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e mësipërme, ka kërkuar që nëpunësja në fjalë të paraqesë pretendime konkrete, lidhur me procesin e vlerësimit. Më tej, nëpërmjet shkresës me nr. 521/1 prot., datë 15.02.2018, pa paraqitur asnjë argument, nëpunësja ka ngritur pretendimin se komentet në të gjitha rubrikat që përmban formulari i vlerësimit të rezultateve në punë, kanë karakter subjektiv, pasi zyrtari raportues (*përgjegjësja e sektorit*) nuk ka qenë në dijeni për detyrat që ajo ka kryer.

Me shkresën nr. 521/2 prot., datë 20.02.2018, *“Mosshqyrtim i vlerësimit të rezultateve në punë nga zyrtari autorizues”*, Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e zyrtarit autorizues, ka çmuar se mosparaqitja e fakteve konkrete, nga ana e nëpunëses \*\*\*\*\*\*, e ka bërë të pamundur rishqyrtimin e vlerësimit të rezultateve në punë.

Më pas, nëpërmjet shkresës me nr. 521/3 prot., datë 26.02.2018, nëpunësja \*\*\*\*\*\* ka vijuar më tej këtë procedurë të nisur, duke paraqitur tek Kryetari i Bashkisë pretendime për vlerësimin e rezultateve në punë, duke përsëritur përfundimin se ka subjektivizëm në perceptimin e punës së saj, nga ana e zyrtarit raportues.

Pas paraqitjes së pretendimeve, Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e zyrtarit autorizues, ka kryer rivlerësimin, në përfundim të të cilit, ka mbajtur të njëjtin qëndrim me

vlerësimin e mëparshëm dhe e ka njoftuar nëpunësen, me shkresën nr. 521/4 prot., datë 05.03.2018, “Rivlerësim i rezultateve në punë”.

Nëpunësja \*\*\*\*\*, e ka kundërshtuar përsëri këtë përfundim të zyrtarit autorizues dhe ka deklaruar në pikën 3, të ndarjes “DH”, “Rivlerësimi nga zyrtari autorizues”, në faqen nr. 6, të formularit të vlerësimit, se do të ankohet ndaj tij në rrugë gjyqësore.

Nga sa parashtroam më sipër, si dhe nga analiza e dokumentacionit të mbledhur gjatë këtij hetimi administrativ, arrihet në përfundimin se kemi të bëjmë me një rast ku nuk është respektuar në përmbajtje neni 62, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimi nr. 109, datë 26.02.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin në punë të nëpunësve civilë” i ndryshuar, që rregullon këtë aspekt në lidhje me nivelin e aktorëve të përcaktuar, për kryerjen e këtij procesi.

Konkretisht, akti i vlerësimit është plotësuar, në cilësinë e “zyrtarit raportues”, nga Përgjegjësi i Sektorit të “Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit”, ndërsa me cilësinë e “zyrtarit kundërfirmues” ka nënshkruar Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

Duke marrë në analizë sa më sipër, konstatojmë se kemi të bëjmë me një kuptim jo të drejtë, lidhur me konceptin e eprorit direkt (“zyrtarit raportues”), i cili është nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë, në linjën e hierarkisë organizative, nëpunësin që do të vlerësohet dhe që është ngarkuar me detyrën për kryerjen e vlerësimit periodik të punës së vartësve të tij.

Sipas nenit 4, pika “e”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është përcaktuar shprehimisht se,

e) “Epror direkt” është:

i) *titullari i institucionit, për nëpunësit civilë të kategorisë së lartë drejtuese, përfshirë nëpunësit në pozicionet e koordinatorit të posaçëm dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë;*

ii) *sekretari i përgjithshëm apo nëpunësi në pozicionin ekuivalent me të, për drejtorët e drejtorive dhe drejtuesit e degëve territoriale të institucionit;*

iii) *titullari i institucionit të varësisë, për drejtorët brenda këtij institucioni;*

iv) *drejtori i drejtorisë, për të gjithë nëpunësit e pozicioneve të tjera.*

Si rrjedhojë, në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunëses \*\*\*\*\*, në cilësinë e eprorit direkt (“zyrtarit raportues”) duhet të paraqitet Drejtori i Drejtorisë Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe jo Përgjegjësi i Sektorit. Ndërsa, Kryetari i Bashkisë do të paraqitet në këtë proces, me cilësinë e “zyrtarit kundërfirmues” dhe “zyrtarit autorizues”. Përgjegjësi i sektorit, si ndjekës i drejtpërdrejtë i punës së specialistëve të sektorit të tij, ka të drejtë të shprehë opinionet dhe vërejtjet e tij për punën dhe sjelljet e vartësve, por këto

gjithmonë, duhet të parashtrihen duke u institucionalizuar tek eprori direkt, në rastin konkret tek drejtori i drejtorisë.

Nisur nga sa më sipër, arrihet në përfundimin se procedura e vlerësimit të rezultateve në punë për nëpunësen \*\*\*\*\*, nuk është kryer sipas nivelit të aktorëve të përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”, i ndryshuar.

Kryerja e procesit të vlerësimit nga përgjegjësi i sektorit, me cilësinë e “Zyrtarit raportues”, është një proces i kryer në mungesë të kompetencës, prandaj duke e cilësuar si në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi të shërbimit civil, në bazë të nenëve 109, pika “a”, dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, duhet të konstatohet si procedurë administrative e paligjshme, e cila me qëllim rivendosjen e ligjshmërisë, duhet të anulohet, e të përsëritet nga fillimi, duke respektuar kompetencën dhe nivelin e aktorëve proceduralë që merren me procesin e vlerësimit periodik të punës së nëpunësve civilë.

#### **Për këto arsye:**

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; në nenin 109 germa “a” dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; e në nenin 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Kryetari i Bashkisë Shijak, në bazë të nenit 109, pika “a”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të konstatojë paligjshmërinë e aktit të vlerësimit të rezultateve në punë, për nëpunësen \*\*\*\*\*, “Specialiste në Sektorin e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit” dhe në bazë të nenit 113 pika “a”, të ligjit të sipërpërmendur, të urdhërojë anulimin e aktit të mësipërm të vlerësimit, duke e kthyer për kryerjen e tij, aktorëve të përcaktuar nga legjislacioni i shërbimit civil.
2. Personat e ngarkuar me ligj, për kryerjen e procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, duhet të kryejnë edhe njëherë nga fillimi, vlerësimin për nëpunësen \*\*\*\*\*, duke mbajtur parasysh rolin e “zyrtarit raportues” dhe zyrtarëve të tjerë, pjesëmarrës në procesin e vlerësimit sipas përcaktimeve në nenin 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësit civil”, të ndryshuar.

3. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 10 ditë nga marrja dijani e këtij vendimi.
4. Njësia Përgjegjëse të njoftojë pjesëmarrësit në procesin e vlerësimit të punës në rolin e “zyrtarit raportues”, “zyrtarit kundërfirmues” dhe “zyrtarit autorizues” për vendimin e Komisionerit, me qëllim që ata të realizojnë detyrat ligjore, të parashtruara në këtë vendim.
5. Me kalimin e këtij afati, institucioni është i detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
6. Të njoftohen për këtë vendim, Bashkia Shijak dhe nëpunësja \*\*\*\*\*.
7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**